



Termtat e referencës

Dizenjues dhe realizues spoti televiziv

Nentor 2018

Titulli i Shërbimit	Dizenjues dhe realizues i një spoti televiziv informues mbi të drejtën e PAK-ve për të votuar
Vendi	Bashkitë e qarkut të Elbasanit (Elbasan, Librazhd, Prrenjas, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh)
Organizata	MEDPAK (Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara)
Kohëzgjatja	Një muaj
Kontrata fillon në datën	14 Nentor 2018
Afati i dorëzimit të materialeve	10/11/2018

Informacion i përgjithshëm

Projekti “Unë votoj dhe kam të drejtë të dëgjohem” i cili po zbatohet nga shoqata MEDPAK (Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara) me financim të “Leviz Albania”, synon që në të shtatë bashkitë e qarkut të Elbasanit të rritet ndërgjegjësimi nga ana e PAK për rëndësinë e votimit si shprehje e demokracisë reale. Në të gjithë qarkun 35 Agjentë për Ndryshim do të ngrenë kapacitetet e tyre lidhur me legjislacionin në fushën e zgjedhjeve dhe do të trajnojnë PAK apo familjarë të tyre rreth të drejtave dhe mënyrat e votimit.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të marrin pjesë në mbledhjet e këshillave bashkiakë dhe takimet apo dëgjesa publike të organizuara në komunitet gjatë periudhës para-elektorale në mënyrë që të bëhen pjesë e vendim-marrjes.

PAK do të përfshihen në monitorimin e planeve sociale të bashkive dhe monitorimin e premtimeve elektorale të zgjedhurve vendorë, për shërbime më të mira ndaj tyre.

Bashkitë dhe kandidatët për kryetar bashkie do të rrisin transparencën e tyre lidhur me shërbimet ndaj AK si dhe do të përfshihen në platformën elektorale këto shërbime të munguara.



Qëllimi dhe shërbimi

Spoti i krijuar do të ketë për qëllim informimin e komunitetit të gjërë të qarkut të Elbasanit por edhe të gjithë Shqipërisë. Ai do transmetohet në television mbi 35 herë sidomos dyjavëshin e fundit përpara zgjedhjeve.

Përgjegjësitë e kompanisë së kontraktuar

- Kompania e kontraktuar do të bashkëpunojë ngushtë me koordinatorin dhe agjentët për ndryshim të të 7-të bashkive të qarkut të Elbasanit. Në konsultim me ta ai do të punoj për dizajnimin apo realizimin e spotit
- Kompania do të përgatisë më shumë se një draft spot, i cili do të diskutohet me shoqatën MEDPAK.
- Kompania do të realizojë spotin sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje.
- Kompania gjatë gjithë kohës së bërjes së spotit do të mbajë kontakt të vazhdueshëm me shoqatën MEDPAK.

Materialet që do të përgatisë experti i kontraktuar.

- Spot televiziv prej dy minutash për sensibilizimin e PAK lidhur me të drejtën për të votuar .

Dokumentat dhe kriteret e kërkuara për aplikantët.

Dokumentacioni

- Nipti i Kompanisë
- Liçensë për ushtrimin e këtij lloji aktiviteti.
- Ekstrakt i thjeshtë dhe historik nga QKR.
- Vërtetim nga gjykata, prokuroria dhe zyra përmbartimore që nuk është në ndjekje penale
- Vërtetim nga zyra e tatim taksave që nuk ka detyrime të pashlyera
- Kostoja e punës duke përfshirë dhe taksat.

Kriteret që duhet të plotësojë experti.

- Eksperience në fushën e bërjes së spoteve, minimum 3 vjet.
- Eksperiencë në punë lidhur me Aftësinë e kufizuar.
- Aftësi logjistike dhe planifikuese, për të realizuar në kohë spotin televiziv.

Të gjithë të interesuarit të dërgojnë aplikimin e tyre deri më datë 10 Nentor 2018 , në adresën e emailit:
info@medpak.org